




Republika e Kosovës



Komuna e Malishevës

Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 27

Datë : 20.04. 2023.

KONTRATË PROKURIMI NR 22

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Dhe

"Genc Zogaj" B.I. (N.T.P. "Media – Stili ") ME SELI NË MALISHEVË ME NR.BIZNESI : 811151779
(ne vazhdim " Furnizuesi "), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizim me:

SHËRBIME ME TEKNIK MUZIKORE PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

me numër identifikues:

Nr1 i prokurimit	62500-23-2545-2-2-1
Nr i brendshëm	62500-23-019-221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **DO TË BËHET SHËRBIME ME TEKNIK MUZIKORE PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE.**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me : **20.04.2023** dhe përfundon në datën: **20.04.2026**.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë : **36 Muaj** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë : **NË INSTITUCIONET ARSIMORE.**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

- Vlera totale indikative e kontratës është : **22,100.00 Euro. (njëzetëedymijënjëqindëeuro).**

- Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është : **plus/minus + - 30% tridhjetë për qind. Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët **SHQIPE**⁴ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Genc Zogaj
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.04.2023	Data:	20.04.2023
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : 20.04.2023.
	6.2	Data e Përfundimit është : 20.04.2026.
	6.3	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : Në Institucionet arsimore të Komunës së Malishevës.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i kontratës është : Enver Mazreku – Zyrta i DKA-së caktuar nga ZKA i AK-së. Menaxheri i kontratës është përgjegjes për mbikqyrjen e ofruesit të shërbimeve të OE për tërë periudhën sa zgjatë kontrata duke filluar nga dita e parë e fillimit të shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Qellimi i mbikqyrjes është të kontrolloj kryerjen e shërbimeve nga OE.
Obligimet e OE	12.4	Shërbime me teknik muzikore për nevojat e institucioneve arsimore duhet të jetë në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri të plotë në specifikacionin e ofertës. Nese shërbimi nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.

Pagesat	13.1	Obligohet AK që mbasi ta e pranon raportin për pranim të Shërbime me teknik muzikore për nevojat e institucioneve arsimore nga zyrtari i caktuar nga ZKA dhe faturën nga OE të ia paguaj shumën sipas nenit 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate. AK e ruan të drejtën që ta e ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe nese nuk iu përmbahet plotësisht kushteve të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është : 10% e Vlerës së kontratës për 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë (100%). b) Përgjegjësia e Palës së Tretë (100%). c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve (100%). d) Përgjegjësia profesionale (100%). e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës (100%).
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e shërbimeve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve,
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për ndermjetesim pranë Ministris së Drejtësis.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË
DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM



SPECIFIKIM I REALIZIMIT ME TEKNIKË MUZIKORE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PËR TRE VITE

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia e Përafërt e Planifikuar	Çmimi për njësi me TVSh	Totali me TVSh
1	Kryerja e shërbimit me teknikë muzikore dhe realizimi i shërbimit me teknikë të Zërimit për shfaqjen e programeve arsimore për 40-të institucionet arsimore.	Copë (Programë)	210	65.00	13,650.00
2	Xhirimi i programit me kamerë dhe regjistrimi i programit në DVD me memorije 4 GB dhe 8 GB. Furnizimi i institucioneve arsimore me një kopje të programit të inçizuar për përdorim për nevojat e shkollave.	Copë (Programë)	130	65.00	8,450.00
TOTALI:					22,100.00

Vrejtje: Shërbimi me teknik muzikore dhe xhirim i programeve do të kryhet në bazë të kërkesës së drejtorëve të shkollave në datë dhe ditë të caktuara në kalendarin e aktiviteteve festive të shkollave për **36 muaj** nga dita e nënshkrimit të kontratës.

